

Zgjeri
26.01.2015



MINISTRIA E FINANÇAVE
Nr. 1280 Prot.
Datë 26.1.2015

Per olizem
AA PSK
DPPP

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 31, datë 21.1.2015

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE
TË SHPALLUR SI FINANÇUES TË TERRORIZMIT",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, e 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, datë 10.10.2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, konkretisht në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", çregjistrohen individët e renditur në shkronjën "a" të listës, "Lista e individëve, anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas ndryshimeve në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, për organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I PUNËVE
TË JASHTME

DITMIR BUSHATI

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (“LISTA E OKB-së”)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në **“Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”**;

1. ISMAIL; MOHAMED; ISMAIL; ABU SHAWEESH,
2. AQEEL; ABDULAZIZ; AQEEL; AL-AQEEL.

Shënim: Gjeneralitet e tjera për personat emrat e të cilave janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.